

VENDIM
Nr. 931, datë 28.12.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE, PËR SHPËRBLIMIN E PUNONJËSVE ME RASTIN E FESTAVE TË FUNDVITIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’i shtohet fondi prej 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekësh, për shpërblimin e punonjësve të saj për festat e fundvitit.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha